

INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË
VERIUT NË VITIN 2024, DERI MË 13.06.2024

Të dhëna javore

Në periudhën 07-13.06.2024 në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 47 raste të reja me pertusis, 23,7% më shumë se javën që shkoi (n=38).

Numri më i madh i tyre (n=36; 76,6%) janë raportuar në Shkup, 5 në Tetovë, 3 në Kumanovë dhe 1 në Ohër, Prilep, Kriva Pallankë. (Tabela 1)

Mosha e të prekurve sillet nga 1 muaj deri në 63 vjet, ndërsa numri më i madh i përkasin grupmoshës 0-4 vjet (n=18; 38,3%).

Nga rastet e reja 6 (12,8%) raste janë hospitalizuar.

Tabela 1. Shpërndarja gjeografike e rasteve me kollë të keqe në RMV, 07-13.06.2024

Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë
Shkup	36
Karposh	6
Kisella Voda	6
Çair	5
Qendër	4
Studenica	3
Aerodrom	3
Kisella Voda	3
Butel	3
Shuto Orizare	2
Gazi Baba	1
Tetovë	5
Tetovë	3
Zhelinë	1
Teapçe	1
Kumanovë	3
Prilep	1
Krivogashtani	1
Ohër	1
Kriva Pallankë	1

Të dhëna kumulative

Në vitin 2024, deri me datë 13.06.2024, në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 746 raste me pertusis, me një incidencë prej 40,6/100,000 banorë.

Shpërndarja e rasteve sipas vendbanimit tregon se numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup - 590 (79,1%) në shtatëmbëdhjetë komuna të ndryshme. (Tabela 2).


42 të sëmurë janë regjistruar në Kumanovë, ndërkohë që raste janë regjistruar edhe në 18 qytete të tjera.

Tabela 2. Shpërndarja gjeografike e rasteve me kollë të keqe në RMV, 2024

Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë	Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë
Shkup	590	Manastir	29
Aerodrom	137	Manastir	28
Karposh	100	Mogilla	1
Kisella Voda	69	Prilep	8
Çair	58	Dollnen	5
Qendër	54	Prilep	3
Gjorçe Petrov	33	Krivogashtani	1
Gazi Baba	31	Gostivar	5
Butel	26	Gostivar	4
Studenica	26	Vrapçisht	1
Saraj	16	Kriva Pallankë	5
Shuto Orizare	16	Kratovë	4
Petrovec	6	Strumicë	3
Haraçina	6	Strumicë	2
Sopishte	4	Bosilovë	1
Çuçer Sandevë	3	Koçan	3
Ilinden	3	Kërçovë	3
Zelenikovë	2	Veles	3
Kumanovë	42	Probishtip	3
Kumanovë	37	Strugë	2
Likovë	5	Dibër	2
Tetovë	35	Krushevë	2
Tetovë	16	Kavadar	2
Zhelinë	7	Gjevgjeli	2
Tearc	6	Ohër	1
Brvenicë	3	Demir Hisar	1
Jegunovc	2		
Bogovinjë	1		

Incidencë më e lartë prej 97,2/100.000 është regjistruar në Shkup, ndërsa incidencë e lartë është regjistruar edhe në Kratovë (53,0/100.000), Kumanovë (33,9/100.000), Manastir (31,2/100.000). (Hartogrami)

Hartogrami. Incidenca në 100.000 banorë sipas QSHP/NJR, kolla e keqe në RMV, 2024




Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, personat e prekur janë nga 1 muaj deri në 78 vjet (mesatarja 11,3 vjet). Numri më i madh i të sëmurëve janë deri në 4 vjet (29%), 141 ose 18,9% i përkasin grupmoshës nën 1 vjet, 75 (10,1%) janë nga 1 deri në 4 vjet.

Incidenca më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet ($I=852,7/100.000$). (Grafiku 1).


Shpërndarja sipas gjinisë tregon se 350 të sëmurë janë meshkuj, ndërsa 396 femra.

Grafiku 1. Shpërndarja e të sëmurëve me kollë të keqe ($n=746$) sipas moshës, në RMV, 2024



Lakorja epidemike tregon se shfaqja e rasteve të reja të kollës së keqe fillon në javën e parë të vitit 2024. Sipas të dhënave vërehet një rritje e vazhdueshme e numrit të rasteve në bazë javore, deri në javën e 12-të.


Grafiku 2. Shpërndarja e të sëmurëve me kollë të keqe (n=746) sipas javës së raportimit (deri më 13.06.2024), në RMV, 2024



Sa i përket statusit të vaksinimit, 463 (62,1%) e pacientëve nuk kanë qenë të vaksinuar ose nuk i kanë pranuar të gjitha dozat sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit, ose nuk ka të dhëna për statusin e vaksinimit. (Grafiku 3).

Të vaksinuar me të gjitha dozat në përputhje me moshën janë 283 persona. (Grafiku 3).

Grafiku 3. Statusi i vaksinimit dhe moshja e të sëmurëve (n=746) me kollë të keqe në RMV



Nga të sëmurët në spital janë shtruar 106 persona (14,2%), ndërsa 90 (84,9%) prej tyre janë nën moshën 4 vjet. Numri më i madh i rasteve (71; 67,0%) janë shtruar në KU për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët në Kozle. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të shtruar në spital, 100 janë lëshuar si të shëruar. Të sëmurët kanë qëndruar në spital mesatarisht nga 9 ditë.

Nga numri i përgjithshëm (n=746) i rasteve të regjistruara me kollë të keqe, 744 janë konfirmuar laboratorikisht, përkatësisht në Avicena (196), Institutin e Shëndetit Publik (101), Biotek (129), Sinlab (58), QSHP Kumanovë (40), SK Sistina (32), QSHP Manastir (22), Laor (22), Instituti i mikrobiologjisë (19), Pllodnost Manastir (13), Klinikën Zhan Mitrev (11), SK Manastir (5), Remedika (4), dhe Ramus (2).

Klasifikimi i rasteve:

Sipas Rregullores për kriteret për definimin e rasteve të sëmundjeve ngjitëse (Gazeta Zyrtare nr. 19/2018), nga numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara (n=746) të kollës së keqe, 744 janë klasifikuar si raste të konfirmuara (të konfirmuara në laborator) dhe dy si të mundshme (ka një lidhje epidemiologjike me një rast të konfirmuar në laborator). Hetimet epidemiologjike tregojnë një lidhshmëri mes 123 rastesh.

Aktivitetet e realizuara për vaksinim me vaksinën e cila përmban komponentë të pertusis në Territorin e Qytetit të Shkupit dhe mbarë vendit.

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Sëmundjeve Infektive dhe të Institutit të Shëndetit Publik, në periudhën nga data 18.01.2024 e deri më tani, në të gjitha pikat e vaksinimit në vend, në bashkëpunim me shërbimet epidemiologjike të QShP-së, është bërë hetim intensiv i të personave të pa evidentuar, personave të pavaksinuar dhe atyre të pavaksinuar plotësisht, si dhe personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, në mënyrë që të thirren dhe të vaksinohen sipas Kalendarit kombëtar të imunizimit.


Shkup - numri i personave të vaksinuar në periudhën 18.01-13.06.2024

Sipas të dhënave të siguruara nga ISHP Shtëpia e Shëndetit - Shkup, nga Shërbimi i Vaksinimit nga Gazi Baba dhe Çairi, Karposh, Kisella Voda dhe Qendra, është konstatuar se janë zbuluar 21.322 fëmijë që kanë lëshuar vaksinimin, dhe prej tyre janë vaksinuar 13.982 (65,6%). Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (6.486; 46,4%).

Sipas moshës dhe Kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 14.368 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (9.222; 64,2%) e fëmijëve të vaksinuar kanë marrë dozën II të revaksinimit në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në territorin e Shkupit në periudhën prej 18.01-13.06.2024 është 28.350.

Grafiku 3. Numri i dozave të administruara në Shkup dhe në qytetet e tjera në RMV, 2024





Maqedonia e Veriut (pa Shkupin) - numri i personave të vaksinuar nga 18.01-13.06.2024

Nga të dhënat e deritanishme të dorëzuara nga Qendrat e Shëndetit Publik, 9.216 fëmijë kanë lëshuar vaksinimin, prej të cilëve 6.097 (66,2%) janë vaksinuar. Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (2.843; 46,6%).

Sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 19.765 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (11.061; 56,0%) e të vaksinuarve kanë marrë rivaksinimin II në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në periudhën nga 18.01-13.06.2024 është 25.862.

Grafiku 3. Numri i dozave të administruara në Shkup dhe në qytetet e tjera në RMV, 2024



Përfundime

- Në vitin 2024 janë regjistruar 746 të sëmurë me kollë të keqe.
- Numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar në territorin e Shkupit (79,1%), ndërsa të sëmurë janë regjistruar në 19 qytete të tjera në RMV.
- Epidemi aktive ka në territorin e Shkupit dhe Kumanovës.
- Numri më i madh i pacientëve i përket grupmoshës 0-4 vjet (29%), incidenca më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet dhe është 852,7/100.000 banorë.
- Nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara (746), 463 raste (62,1%) nuk kanë qenë të vaksinuar, nuk kanë qenë të vaksinuar sipas moshës së tyre ose nuk ka të dhëna për vaksinimin.
- Nga fëmijët që janë vaksinuar plotësisht (n=224), koha mesatare e kaluar nga doza e fundit e vaksinës deri në shfaqjen e sëmundjes është 12.5 vjet.
- Nga 699 rastet e raportuara, në laborator janë konfirmuar 744 raste.

- Nga 18.01-13.06.2024, janë dhënë gjithsej 54.212 doza të vaksinës e cila përmban komponentë kundër kollës së keqe.

Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive
ISHPRMV

14.06.2024